



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Pala kërkuese **Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**, me datë **03.09.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “**1.**Të caktohet ndaj shtetasit **Redi Molla** afati i ri i paraburgimit prej 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga data 28.03.2024; **2.**Të caktohet ndaj shtetasit **Mariglen Qato** afati i ri i paraburgimit prej 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga data 28.03.2024; **3.**Të zgjatet afati i paraburgimit për shtetasin **Taulant Tusha** për 3 (tre) muaj, nga data 28.09.2024 deri në datën 28.12.2024”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Irena Gjoka, bazuar në nenet 112, 263/1 gërmat b) dhe c), 263, pikat 6 dhe 7, 264/2 të Kodit të Procedurës Penale; me vendimin Nr. **508**, datë **23.09.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së paraqitur nga pala kërkuese, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

2. Caktimin e afatit të ri të paraburgimit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, **duke filluar nga data 28.03.2024 deri në datën 28.03.2025**, ndaj shtetasit nën hetim **Redi Molla**, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në 7 (shtatë) raste, nga këto 4 (katër) raste të kryera në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 259 dhe 25 të Kodit Penal, sipas përmbajtjes së kësaj dispozite para ndryshimeve të kryera me ligjin nr.43/2021, datë 23.03.2021; "*Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rreme i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarin*", të kryer në 5 (pesë) raste, të parashikuar nga neni 257/a/ 2 i Kodit Penal; "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*" të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

3. Caktimin e afatit të ri të paraburgimit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, **duke filluar nga data 28.03.2024 deri në datën 28.03.2025**, ndaj shtetasit nën hetim **Mariglen Qato**, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", në 4 (katër) raste, të kryera në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 259 dhe 25 të Kodit Penal, sipas përmbajtjes

së kësaj dispozite para ndryshimeve të kryera me ligjin nr.43/2021, datë 23.03.2021;"Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rreme i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal;"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

4. Zgjatjen e afatit të paraburgimit, edhe për një periudhë 3 (tre) mujore për shtetasin nën hetim **Taulant Tusha**, duke filluar nga data **28.09.2024** deri në datën **28.12.2024**, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal, sipas përmbajtjes së kësaj dispozite para ndryshimeve të kryera me ligjin nr.43/2021, datë 23.03.2021 dhe "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", të kryer në bashkëpunim, e kryer dy herë, të parashikuar nga neni 258/2 dhe 25 i Kodit Penal.

5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 5 (pesë) ditëve, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 23.09.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar